Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0988

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani kryetare, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Gëzime Gashi" B.I. të datës 07.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur të datës 23.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet për ngrohje për nevojat e shkollave" me numër të prokurimit 97500-23-10715-1-2-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 10.01.2024merr këtë:

Vendim

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "Gëzime Gashi" B.I. me nr. 2023/0988 e datës 07.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur të datës 23.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet për ngrohje për nevojat e shkollave" me numër të prokurimit 97500-23-10715-1-2-1.

II.Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur të datës 23.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

III. Konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 05.10.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet për ngrohje për nevojat e shkollave" me numër të prokurimit 97500-23-10715-1-2-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të

hapur me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 119,700.00€.

Me datë 23.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik "Wood Company" Sh.P.K. Me datë 27.11.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 30.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar në tërësi kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 07.12.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0988.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.\

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: *"OE RRON 2019 i ka prezantuar i ka prezantuar Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në ATK me shumën 175,484.27 € dhe e ka informuar AK Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rrituve se ky qarkullim në ATK është pa TVSH, kjo për faktin se në ATK nuk prezantohet qarkullimi me TVSH. Për ta siguruar AK se qarkullimi i OE RRON 2019 është më i lartë se vlera e kërkuar e qarkullimit në përgjigje të sqarimeve të kërkuara, ia ka përcjell qarkullimin bankar që dëshmon se OE RRON 2019 i përbush kërkesat ekonomike dhe financiare".*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 59, 68 dhe 72 të LPP si dhe pikën 8 të UPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të miratohet ankesa ashtu që të kthehet lënda në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11.12.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 19.12.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK*".

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet ankimore, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Operatori Ekonomik ankues ka dorëzuar deklaratën e ATK-së si dëshmi qarkullimi per vitin 2022 ku qarkullimi sipas kësaj deklarate arrin vlerën prej 175,484.27€. Autoriteti Kontraktues gjatë fazës se vleresimit ka kërkuar sqarime shtesë sipas neit 59 dhe 72 te LPP nga operatori ekonomik ankues i cili ka kthyer sqarimet e kërkuara. Operatori Ekonomik ankues përmes dëshmisë se ofruar nuk ka përmbushur totalin e qarkullimit te kërkuar nga Autoriteti Kontraktues përmes dëshmisë së ATK. Kërkesa dhe Dëshmia e kërkuar nga Autorteti Kontraktues në dosje te tenderit ka qenë e çart se duhet të plotësohet kriteri i qarkullimit në 3 vite (2020, 2021 dhe 2023) në shumën jo më pak se 200.000.00€ dhe duhet të dëshmohet me deklaratën vjetore të dorëzuar në Admnistraten Tatimore të Kosovës. Në këtë mënyrë operatori ekonomik ankues nuk ka përmbushur kriterin e përzgjedhjes tek kërkesat ekonomiko/financiare dhe nuk është në harmoni me nenin 59 pika 4. Bazuar ne sqarimet lartekura, kërkesat e dosjes se tenderit, ofertën e operatorit ekonomik ankues, sqarimet shtesë, dhe te gjitha shkresat e lëndës konstatojmë se pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i pabazuar".

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku ka vendosur se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në këtë mënyrë është

gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të cilat pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues pa nevoj që të njëjtat të përshkruhen sërish në detaje.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"* kur ka refuzuar ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme, sepse apriori Paneli Shqyrtues ka gjetur se kërkesa e dosjes së tenderit të cilit i referohet pretendimi ankimor është formuluar si në vijim: "*Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) gjatë tri viteve (2020, 2021, 2022) kanë qenë në shumë jo më pak se 200,000.00€*". Ndërsa dëshmia e kërkuar ka qenë: "*Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ose nga vendi i origjinës*". Nga oferta e operatorit ekonomik ankues është gjetur se i njëjti në vitin 2020 dhe 2021 nuk ka fare qarkullim ndërsa në vitin 2022 ka dëshmuar qarkullimin prej 175,484.27€. Me këtë rast autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP mirëpo sërish operatori ekonomik ankues nuk ka arritur që të dëshmoj qarkullim më shumë se 200,000.00€ sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor është i pabazuar. Duke qenë se edhe eksperti ka arritur deri te përfundimi i njëjtë, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit lidhur me pretendimet ankimore.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike si më sipër, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur të datës 23.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pelet për ngrohje për nevojat e shkollave" me numër të prokurimit 97500-23-10715-1-2-1 si dhe të konfiskohet tarifa e

ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**
- OE - **Gëzime S. Gashi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: